



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 15.09.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 11.09.2020 të parashtruar nga Grupi Operatorve Ekonomik "Euroasphalt "Sh.p.k & "Trasing Group" sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Qarkores – Tranziti i ri", me Nr. të Prok: 632-19-2998-5-1-1 nxjerr:

### V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të Operatorve Ekonomik "Euroasphalt "Sh.p.k & "Trasing Group" sh.p.k., e dt. 11.09.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Qarkores – Tranziti i ri", me Nr. të Prok: 632-19-2998-5-1-1, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, te AK –së, të datës 07.09.2020 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 07.09.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

### A r s y e t i m

Grupi Operatorve Ekonomik "Euroasphalt "Sh.p.k & "Trasing Group" sh.p.k., me datë 11.09.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Qarkores – Tranziti i ri", me Nr. të Prok: 632-19-2998-5-1-1,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 15.09.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas rishikimit të dokumenteve, autoriteti Kontraktues, konstaton se Operatori Ekonomik "Drini Company" sh.p.k, i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Tenderi juaj është eliminuar për arsye se nuk plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

**Faton Gutaj**  
**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës